

**VENDIM**  
**Nr. 555, datë 15.7.2020**

**PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE PËRPARËSITË PËR AKORDIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 janarit të çdo viti, paraqesin kërkesat për grante të menjëhershme për banesat me kosto të ulët, pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin për t’u planifikuar në buxhetin e vitit pasardhës.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin brenda muajit mars planifikon nevojat për fonde për grante të menjëhershme për vitin pasardhës të buxhetit të shtetit, bazuar në kërkesat vjetore të njësive të vetëqeverisjes vendore.

3. Me miratimin e ligjit për buxhetin e shtetit të vitit pasardhës, njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet ministrisë përgjegjëse për strehimin kërkesat për çeljen e fondeve të planifikuara në vitin korrent, shoqëruar me kostot financiare për familje sipas formularit të shtojcës “A”, bashkëlidhur këtij vendimi, pasi ka verifikuar:

a) të dhënat e kontratës me subjektin, me të cilin individ/familja ka lidhur kontratën e kreditimit ose kontratën e shitblerjes së banesës me kosto të ulët;

b) faktin nëse individ/familja ka përfituar më parë nga programe për dhënie granti apo nga zbritje të vlerës së banesës, për shkak të statusit të familjes ose të ndonjë prej anëtarëve të saj.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas çeljes së fondit nga ministria përgjegjëse për strehimin dhe në varësi të formës së përfitimit të banesës me kosto të ulët nga familja/individ, akordojnë fondet në favor të:

a) kryefamiljarit/es që ka lidhur kontratë shitblerjeje me një subjekt ndërtues publik ose privat;

b) institucionit publik që ka siguruar banesën me kosto të ulët, vlerën e të cilit familja e shlyen me këste mujore;

c) institucionit financiar që ka akorduar kredinë sipas një marrëveshjeje të nënshkruar midis tij dhe subjekteve shtetërore, sipas nenit 47, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me qëllim reduktimin e kësteve mujore që paguan individ/familja.

5. Nga kategoritë e parashikuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, për përfitimin e grantit të menjëhershëm përfitojnë me përparësi:

a) kryefamiljarët me aftësi të kufizuara;

b) familjet me më shumë se një person me aftësi të kufizuara;

c) individët me statusin e jetimit, të cilët jetojnë në banesa të papërshtatshme ose në konvikte;

ç) individët me statusin e jetimit që kanë në ngarkim vëllezër dhe motra, të papunësuar;

d) kryefamiljarët e vetëm, viktimë e dhunës në familje;

dh) familjet njëprindërore të minoritetit rom dhe egjiptian;

e) familjet/individët të parashikuar në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që kanë rënë në vështirësi financiare dhe që rrezikojnë të humbasin banesën me kosto të ulët që kanë blerë me kushte kreditimi.

6. Në rastet e parashikuara në shkronjën “e”, të pikës 5, të këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore mbështet familjen/individin, që ka rënë në vështirësi financiare, duke siguruar financimin e grantit të menjëhershëm në një kohë sa më të shpejtë dhe gjithmonë jo më

vonë se 30 ditë nga paraqitja e kërkesës për grantin e menjëhershëm. Për marrjen e këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore bazohet në:

a) vërtetimin për gjendjen financiare të krijuar për familjen/individin dhe shkaqet që kanë sjellë vështirësinë financiare të krijuar;

b) informacionin e nevojshëm të marrë nga institucioni që ka kredituar familjen/individin për pamundësinë e shlyerjes së kredisë, për shkak të gjendjes së vështirë financiare;

c) vërtetimin nga institucioni që ka kredituar familjen/individin se shumica e grantit është e mjaftueshme për të lehtësuar pagesat e kredisë.

7. Përparësitë, sipas pikës 5, të këtij vendimi, shërbejnë për përshpejtimin e afatit kohor të livrimit të grantit dhe nuk përjashtojnë përfitimin nga granti i menjëhershëm i kategorive të familjeve/individëve, të parashikuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që nuk kanë një nga karakteristikat e pikës 5, të këtij vendimi.

8. Për përfitimin e grantit të menjëhershëm, familja/individit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

9. Dokumentet sipas pikës 8, të këtij vendimi, si edhe çdo akt apo dokument që vërteton njëri prej situatave të parashikuara në pikën 5 të këtij vendimi, dorëzohen vetëm atëherë kur ato apo njëra prej tyre nuk janë dorëzuar gjatë aplikimit dhe përfitimit të banesës me kosto të ulët.

10. Familjet/individët sipas kategorive të përcaktuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si rregull paraqesin kërkesën për përfitimin e grantit të menjëhershëm pranë njësive të vetëqeverisjes vendore së bashku me kërkesën për t’u trajtuar me banesë me kosto të ulët.

11. Përjashtimisht, kur familja/individit që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” e “b”, të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që ka përfituar banesë me kosto të ulët në zbatim të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, si edhe kur ka përfituar banesë me kosto të ulët me fondet e planifikuara për periudhën 2018 dhe 2019 dhe është në një marrëdhënie kontraktore me një institucion publik ose privat për shlyerjen e kredisë apo të vlerës së banesës, por nuk ka mundur të përfitojë grantin e menjëhershëm apo kur i është krijuar statusi i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, pasi ka përfituar banesën me kosto të ulët, mund të paraqesë kërkesë për përfitimin e grantit të menjëhershëm pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore në çdo kohë, së bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton statusin. Këto familje/individë e përfitojnë grantin e menjëhershëm, sipas parashikimeve të pikës 10, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

12. Lista e përfituesve, e cila hartohet nga zyra përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas dokumentacionit përkatës, vlerësohet nga struktura përgjegjëse për strehimin dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

13. Vendimi nr. 527, datë 6.8.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët”, shfuqizohet.

14. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për strehimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**

SHTOJCA A  
TABELA E PARAQITJES SË KËRKESËS SË NJËSISË SË VETËQEVERISJES  
VENDORE NË MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR STREHIMIN PËR GRANT TË  
MENJËHERSHËM

Nr.	Emër Mbiemër	Kontrata e lidhur me (p.sh. EKB ose Banka xx)	Vlera e shitblerjes sipas kontratës	Shuma e grantit që kërkohet nga buxheti (4 x 10%)
1	2	3	4	5